# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-455579**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 'Nëse shpërthen lufta, largohuni drejt Polonisë', Lituania përgatit planin e evakuimit për banorët e kryeqytetit në rast të një sulmi rus - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/nese-shperthen-lufta-largohuni-drejt-polonise-lituania-pwrgatit-planin-e-evakuimit-per-banorwt-e-kryeqytetit-nw-rast-tw-njw-sulmi-rus` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:50:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:49:57 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8eebb34fe65db2eb1aefcb983da816461b296f6edcf93ddb197a8943204e39ed` |
| TEKSTI | `6afff54d590117247bc38964e7932aef4bcd64488fdd6a54977a5bfff9e61fed` |
| PAMJA | `1be3116e6131d726deb6613a6872caf798b8310a4a78623ddf86c583c1b91152` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6bed07874a587fc4491a622d3afcaa84d2b978752794a9270758e9c6a14e71f1` |
| E MËPARSHMJA | `3b91f14ed80d273b36b81dc4098c6049d0c27b6751c7617b252b1512c0813830` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6bed07874a587fc4491a622d3afcaa84d2b978752794a9270758e9c6a14e71f1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Zgjedhjet në Rusi/ Dalin rezultatet e para, partia 'Rusia e Bashkuar' e mbështetur nga Putini drejt një fitoreje të thellë

Bota

# 'Nëse shpërthen lufta, largohuni drejt Polonisë', Lituania përgatit planin e evakuimit për banorët e kryeqytetit në rast të një sulmi rus

*Autoritetet në Vilnius kanë përcaktuar korridoret e largimit në rast kërcënimi ushtarak. Polonia po përgatit një korridor tranziti për qytetarët që mund të evakuohen nga shtetet baltike.*



*Foto ilustruese*




Redaksia
18 Shtator, 16:47 | **Përditësimi: 18 Shtator, 16:49**

Share Tweet

Çfarë ndodh nëse lufta troket në derë? Në Lituani, autoritetet kanë tashmë një përgjigje.

Vilniusi ka bërë publik planin e evakuimit për rastet e një kërcënimi ushtarak ose të një krize të madhe, duke përcaktuar edhe drejtimet nga ku do të largohen banorët nëse situata e sigurisë përkeqësohet. Një prej korridoreve kryesore të evakuimit do të jetë drejt Polonisë, ndërsa rrugë të tjera janë parashikuar në veri dhe perëndim të vendit.

Shefi i Departamentit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë së Vilniusit, Zhigimantas Solovjovas, tha se koha dhe drejtimi i evakuimit do të varen nga vendndodhja dhe niveli i kërcënimit. Sipas tij, plani është përditësuar rreth një vit më parë dhe parashikon që largimi i popullsisë të organizohet nga autoritetet, në mënyrë që të shmanget një eksod i pakontrolluar.



LEXO EDHE:
**Zgjedhjet në Rusi/ Dalin rezultatet e para, partia 'Rusia e Bashkuar' e mbështetur nga Putini drejt një fitoreje të thellë**

Por zyrtarët japin edhe një paralajmërim të qartë: qytetarët nuk duhet të presin që të largohen pasi bombardimet kanë nisur.

"Banorët e Vilniusit nuk duhet të presin të largohen nga qyteti përgjatë rrugëve të evakuimit gjatë bombardimeve", u shpreh Solovjovas. Ai theksoi se nëse sulmi ka filluar, banorët duhet të kërkojnë strehim dhe jo të përpiqen të largohen nga qyteti.

Në të njëjtën kohë, edhe Polonia po përgatitet për një skenar të tillë. Autoritetet në rajonin verilindor të Podlaskies po punojnë për krijimin e një korridori tranziti për qytetarët që mund të evakuohen nga Lituania dhe shtetet e tjera baltike. Në përgatitje janë përfshirë pushteti vendor dhe strukturat përkatëse, me synimin që të mund të priten të evakuuarit dhe të koordinohet transporti i tyre i mëtejshëm.

Sipas Radios Polake, këto masa lidhen me situatën e sigurisë në kufirin lindor të Polonisë dhe me rrezikun e një përshkallëzimi të konfliktit. Megjithatë, autoritetet sqarojnë se bëhet fjalë për plane emergjence dhe jo për një urdhër evakuimi.

Lituania, anëtare e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, kufizohet me enklavën ruse të Kaliningradit dhe me Bjellorusinë, aleaten më të afërt ushtarake të Moskës. Plani i evakuimit ishte hartuar përpara incidentit të kësaj jave, kur një dron nga Bjellorusia hyri në hapësirën ajrore lituaneze dhe u rrëzua nga një avion luftarak i NATO-s. Ministri lituanez i Mbrojtjes, Robertas Kaunas, deklaroi se në dron ishte gjetur një mjet shpërthyes.a

U.D/Shqiptarja.com

TAG: lituani Rusi poloni

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★ ★★★★★ 1.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

## Komente

Komento

Igor: 18/09/2026 16:59

LAJME ABSURDE SIKUR DIKUSH DOTE KISHTE KOHEN PER TU LARGUAR NESE PELSET NJI LUFTE NE NJI VEND TE NATOS DON TE THOTE FUNDI I NJEREZIMIT.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Dita e fundit e zgjedhjeve në Rusi, Moska: Sistemet tona të votimit në shënjestër të sulmeve kibernetike**

20 Shtator, 12:30



**Sulm masiv me 1.110 dronë ukrainas ndaj Rusisë, 2 të vdekur, goditet një rafineri nafte! Kryebashkiaku i Moskës: Synojnë të pengojnë zgjedhjet**

20 Shtator, 07:45



**Putin: Rusia nuk ka qëllime agresive, gati për të rivendosur marrëdhëniet**

19 Shtator, 22:31



**Zelensky pret Vuçiçin në Ukrainë: Diskutuam për integrimin evropian të 2 vendeve dhe situatën me sulmet ruse**

18 Shtator, 21:00



**'Do pushtojmë gjithë Donbasin brenda disa muajsh'- Dhëndri i Trump 'sfidon' Putinin në zyrën e tij: Kështu the edhe një vit më parë, por nuk ndodhi gjë!**

18 Shtator, 19:35



**Ky është aplikacioni që dyshohet se përdor Rusia për të përgjuar qytetarët e saj, miliona rusë e kanë të instaluar me detyrim**

18 Shtator, 18:08









Nisin zgjedhjet 3 ditore parlamentare në Rusi, Putin voton online nga zyra e tij në Kremlin

18 Shtator, 16:52



Finlanda iu bashkua iniciativës së Francës, Rusia akuzon vendin fqinj: Po përpiqeni të luani me armët bërthamore!

18 Shtator, 16:47



Rusia kërkon tërheqjen nga territori japonez të sistemit raketor 'Typhon' të prodhuar në SHBA: Përbën kërcënim për sigurinë tonë!

18 Shtator, 16:15



Presidenti francez Macron: Sulmet hibride ruse kundër Evropës po intensifikohen, s'do të mbeten pa përgjigje!

18 Shtator, 15:39



Trump: SHBA dhe Polonia po bëjnë 'përparim të madh' drejt një baze të re të ushtrisë amerikane

18 Shtator, 11:11



Rusia dhe Kina vendosin veton ndaj SHBA-së në OKB, bllokohet monitorimi i sanksioneve ndaj Iranit

18 Shtator, 08:22

Kodi Etik Kontakt Rreth Nesh Raportoni Ju Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.